



Marrëveshje Bashkëpunimi

E lidhur në Prishtinë, me datë 20.06.2022, në mes të palëve kontraktuse, dhe atë:

“OLIVE Medical Group” SH.P.K me Nr. unik identifikues 810028705 me adresë të selisë në:
Rr. Fadil Hoxha Lagjia Kalabria Kati-2 Objekti EXDC-4 Prishtinë, e përfaqësuar nga z.Fatmir
Sejdiu dhe

Sindikata e Policisë së Kosovës, regjioni në Mitrovicë të cilën e përfaqson kryetari Avni
Tahiri

Neni 1

QËLLIMI I KONTRATËS

Kjo kontratë lidhet në mes të palëve kontraktuese me qëllim të përcaktimit të të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisive profesionale dhe juridike që lidhen me ofrimin e shërbimeve që janë objekt i kësaj kontrate.

Neni 2

LËNDA E KONTRATËS

Palët kontraktuese, me vullnet të plotë dakordohen që të kryejnë shërbime laboratorike dhe konsultave mjekësore sipas nevojës dhe kërkesës së palës tjetër, sipas specifikave të përcaktuara me këtë kontratë.

Neni 3

SHËRBIMET

Olive Medical Group ofron këto shërbime:

1. Analiza laboratike: Biokimi, Mikrobiologji dhe Patologji.

Neni 4

Njesitë e Shërbimeve

Olive Medical Group ofron këto shërbime për Anëtarët e Sindikatës së Policisë në lokacionet:

1. Rruga Minatorët e Trepçes, Mitrovicë;

Neni 5

OBLIGIMET E PALËVE

Palët kontraktuese, me vullnet të plotë deklarojnë se posedojnë të gjitha kapacitetet njerëzore, profesionale, teknike, logjistike të cilat janë të nevojshme, domosdoshme dhe të mjaftueshme për ofrimin e shërbimit për palën tjetër.

Neni 6

ZOTIMI LIGJOR DHE PROFESIONAL

Palët kontraktuese zotohen që të gjitha shërbimet e ofruara për njëra-tjetrën dhe që janë objekt i kësaj kontrate, do të kryhen në mënyrë profesionale, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet lidhur me shërbimet e ofruara.

Neni 7

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

1. Efekti juridik i kësaj kontrate është 1 vjet nga data e hyrjes në fuqi.
2. Sipas dakordimit reciprok të palëve, kjo kontratë mund të vazhdohet në afat të pacaktuar.
3. Vazhdimi sipas pikës 2 të këtij neni bëhet automatikisht, nëse gjysmën e muajit të fundit para përfundimit nuk paralajmërohet me shkrim pala tjetër për përfundim të kontratës.

Neni 8
PAGESAT DHE ÇMIMET

1. Pagesat do të bëhen nga personat që do të japin mostrat për analiza në mënyrë individuale.
2. Çmimet e detajuara për shërbimet që janë objekt i kësaj kontrate do të jenë:
 1. Për anëtarët e Sindikatës së Policisë për analiza do të ofrohet 20% zbritje;
 2. Për familjarët e ngushtë të anëtarëve të Sindikatës së Policisë, për analiza laboratorike do të ofrohet 20% zbritje;
 3. Këto zbritje ofrohen vetëm për analizat të cilat punohen brenda vendit.

Neni 9
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. Anëtarët e Sindikatës së Policisë do të caktojnë termine për rastet të cilat kanë nevojë të marrin shërbime brenda poliklinikes Olive;
2. Anëtarët e Sindikatës së Policisë me rastin e paraqitjes për shërbime, duhet të tregojnë kartelen e tyre, në mënyrë që të përfitojnë zbritjen që do të aplikohet sipas kësaj marrëveshje.
3. Stafi i Olive-së do të ofrojë të gjitha shërbimet e kërkuara nga ana e pacientëve në kohë dhe mënyrë të duhur.

Neni 10
NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI

1. Kjo kontratë nënshkruhet në 2 (dy) kopje identike, nga 1 për secilën palë kontraktuese.
2. Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në datën 20.06.2022

Palët Kontraktuese

Olive Medical Group SH.P.K



Sindikata e Policisë së Kosovës

Regjioni Mitrovicë

Kryetari i Sindikatës

